



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Njesta Org. Org. Jedin.	01	Nr. Prot. Br. Prot.	57
Nr. i faqeve Broj stranica	03	Data Datum	14/03/2016
No. pages:			
PRISHTINË/A			

Nr. prot. 57/2016
Datë: 02.03.2016

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.3) të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. **Urdhërohet** Komuna e Gjilanit të ndalojë përkohësisht kryerjen e shërbimeve në E-Kioske për qytetarët deri në ndërmarrjen e masave dhe procedurave për sigurimin e nevojshëm të të dhënave personale në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. **Urdhërohet** Komuna e Gjilanit të de- instalojë sistemin dhe të largojë fizikisht aparaturën për përpunimin e të dhënave të karakteristikave biometrike (gjurmët e gishtërinjve), dhe të bëjë fshirjen e të dhënave personale në pajtim me ligjin.
3. Komuna e Gjilanit në afat prej 15 ditësh duhet ta njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 01/03/2016, Agjencia sipas detyrës zyrtare ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në Komunen e Gjilanit. Pas inspektimit është përpiluar procesverbali me nr. 01/2016, i cili është nënshkruar nga mbikëqyrësi shtetëror dhe Z. Nazim Gagica Drejtor i Drejtorise per Administratë në Komunen e Gjilanit dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Adresa: Rr. Luan Haradinaj p.n. 10000 Prishtinë – Kosovë

-Sigurimi i përpunimit të të dhënave-

- Nga ana e zyrtarit të TI-se së Komunes së Gjilanit Z. Gazmend Jakupi u deklarua se ata posedojnë serverin e tyre në komune me user dhe pass të vetin i cili është i vendosur në dhomë të vecantë dhe i mbyllur me çelës.

- Në server grumbullohen të dhënat e qytetarëve të cilët kryejnë shërbimet e nxjerrjes së ekstrakteve dhe certifikatave të lindjes. Këto shërbime kryhen vetëm përmes shtypjes në mënyrë manuale të numrit personal të letërnjoftimit të individit të caktuar, ku Z. Aleksandar Spasic dhe Z. Shpend Reçica e provuan këtë shërbim duke përdorur numrat e tyre personal të letërnjoftimeve dhe në ekran u paraqitën certifikatat e tyre të lindjes. Kjo nënkupton që secili individ po që se e posedon numrin e letërnjoftimit të ndonjë personi tjetër ka qasje në të dhëna si për shembull: sindikatat e punetoreve, organizatat jo qeveritare, partitë politike të cilat posedojnë listat e individëve me të dhëna të tyre mund të kenë qasje lehtësisht në këtë aparaturë. Me fjalë të tjera niveli i masave të sigurisë së mbrojtjes së të dhënave personale nuk është në nivelin e duhur.

Përpunimi i karakteristikave biometrike -

- Në aparaturën e E- Kioskës u vertetua se është e vendosur pjesa shtesë për marrjen e shenjave të gishterinjëve të qytetarëve përdorues të shërbimeve. Mirëpo Z. Gagica dhe Z. Jakupi u deklaruan se ajo pjesë nuk është në funksion që nga fillimi kur është vendosur E- Kioska për shkak të dilemave të cilat i kanë pasur në raste të ankesave të mundshme të qytetarëve. Mirëpo gjatë bisedës u konstatua se qëllimi i tyre për vendosjen e kësaj pjesë për ruajtjen e shenjave të gishtërinjëve të qytetarëve ka qenë në njëfarë mënyre që të evidentohen kërkuesit e shërbimeve.

Andaj,

Lidhur me pikën 1, të këtij vendimi sipas LMDHP nëni 49 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.3 e përcakton të drejtën ligjore të mbikqyrësit shtetëror i cili në raste kur vëren shkelje të ligjit të lartëpërmendur që e rregullon përpunimin e të dhënave personale që menjëherë "të ndalojë përkohësisht dhe në mënyrë të caktuar përpunimin e të dhënave personale". Poashtu nëni 14 i LMDHP paragrafët 1,1.3 dhe 2 e parasheh sigurimin e përpunimit të të dhënave ku përpunuesi i të dhënave duhet të sigurojë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave duke parandaluar çfarëdo qasje të paautorizuar në ose leximin e të dhënave personale gjatë ruajtjes dhe transmetimit të tyre, përfshirë transmetimin nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit dhe rrjeteve.

Ndërsa për pikën 2 të vendimit, LMDHP në nenin 66 paragrafi 1 parasheh se "Sektori publik mund të përdor karakteristikat biometrike, vetëm nëse domosdoshmërisht kërkohet për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pronës ose mbrojtjen e të dhënave konfidenciale dhe sekreteve të biznesit, nëse kjo nuk mund të arrihet me mjete më të lehta".

Ndërsa në situatën e konstatuar në Komunën e Gjilanit nuk korrespondon marrja e shenjave të gishtërinjëve të qytetarëve gjatë kryerjes së shërbimeve të tyre personale me nivelin e nevojshëm të sigurisë së përpunimit të të dhënave. Në mënyrë të njëjtë si operimi me sistemin bankar ku individët kryejnë shërbime të ndryshme të transaksioneve monetare përmes kartelave personale me kod të fshehur ku nuk ka hapsirë për abuzime, ngase individ